

6118
19.11.2021
Krimi
H. Jona



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E APELIT
KORÇË

- D.T.I.M.P.V.
- Mj. Ad. Pirg
- Mj. Ad. Lilevish
- 18.11.2021

Nr. 97 Regj. Themeltar
Data e regjistrimit 7.4.2021

Nr. 82 Vendimi
Data e vendimit 28.5.2021

V E N D I M
“Në emër të Republikës”

Gjykata e Apelit Korçë, e përbërë nga gjyqtarët:

Kryesues: Dritan HASANI
Anëtare: Elbana LLURI
Anëtare: Arta DUKA

dhe sekretare gjyqësore Anila Grabocka, në Korçë, sot më 28 maj 2021, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi, çështjen penale nr. 57/167Regj. Themeltar, që i përket palëve:

Kërkues: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

Objekti: Pushimin e çështjes që i përket procedimit penal nr. 1107, viti 2020, me objekt hetimin e veprës penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290/3 i Kodit Penal.

Baza ligjore: Neni 328/1, shkronja “h” e 329/a të Kodit të Procedurës Penale.

Me pjesëmarrjen në gjykim:

- të personit nën hetim, shtetasit Endri Isallari, i biri i Erzen dhe Fatbardha, i datëlindjes 2.1.1994, lindur në Pogradec dhe banues në fshatin Nizhavec, Njësia Administrative Çerrave, Bashkia Pogradec, me shtetesi shqiptare, me gjendje civile beqar, me arsim të mesëm, i padënuar me parë, mbrojtur në gjykimin në shkallë të parë nga av. Ledian Spaho, zgjedhur nga personi nën hetim;

- të trashëgimtarëve të viktimitës,

1-Bukurije Likaj, e bija e Hamit (Kosta) dhe Satber (Sofia), e datëlindjes 15.3.1960, lindur në fshatin Beras dhe banuese në fshatin Pirg, Njësia Administrative Pirg, Bashkia Maliq.

2- Liljana Fasho, e bija e Hamit (Kosta) dhe Satber (Sofia), e datëlindjes 15.6.1966, lindur në fshatin Beras dhe banuese në fshatin Vashtemi, Njësia Administrative Libonik, Bashkia Maliq,

3- Vangjel Muçollari, i biri i Kosta dhe Sofia, i datëlindjes 5.12.1969, lindur në fshatin Beras dhe banues në qytetin e Maliqit, Bashkia Maliq; të tre trashëgimtarët e viktimitës janë mbrojtur në gjykimin në shkallë të parë nga av.

Rizvaldo Vrenozi, zgjedhur prej tyre.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr. 41-2021-1057 (223 SP), datë

Nr. 111 Prot
Dt. 19.11.2021



RR 654 600 619 AA

24.3.2021, ka vendosur:

1. Kthimin e akteve Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, prokurorit Julian Kristo dhe urdhërimin e tij të bëjë plotësimin e hetimeve në lidhje me procedimin penal nr. 1107, viti 2020, duke kryer veprimet hetimore të përshkuara në pjesën arsyetuese të këtij vendimi.
2. Plotësimi i hetimeve do të bëhet brenda një afati prej 2 muaj.
3. Një kopje e këtij vendimi t'i dërgohet prokurorit të çështjes Julian Kristo dhe një kopje t'i njoftohet drejtueses të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, znj. Dhorina Theodhori. (...).

Kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë, ka paraqitur ankim Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, e cila ka paraqitur shkaqet e ankimit, në mënyrë të përmbledhur, si vijon:

- Nga aktet e fashikullit të hetimeve paraprake të procedimit penal nr. 1107, viti 2020, rezulton fakti se në datë 10.11.2020, rreth orës 09:30, në rrugën urbane të qytetit të Maliqit, ka ndodhur një aksident automobilistik, në vendin e quajtur "Selia e Partisë Demokratike". Shtetasi Endri Isallari ka qenë i punësuar si shofer shpërndarës pranë subjektit "Vita 2001" dhe ka qenë duke drejtuar automjetin e tij, me targa AA927KO, e në të njëjtin vend ka qenë duke ecur shtetasi Kosta Muçllari. Në një çast, drejtuesi i mjetit ka kryer manovrën, duke ecur pas (indietro) dhe ka goditur në pjesën e pasme të automjetit viktimën, i cili si pasojë e kësaj goditjeje, ka pësuar dëmtime e pas dërgimit në spital, ka vdekur;
- Bazuar në ekspertimin mjeko-ligjor, rezulton se dëmtimet në trupin e viktimës janë shkaktuar me mjet të fortë mbretës, me mekanizimin e goditje-përplasjes, karakteristikë e aksidenteve automobilistike, si dhe se shkak i vdekjes së tij ka qenë politrauma dhe contuzioni i rëndë i trurit;
- Bazuar në ekspertimin auto-teknik, datë 3.12.2020, rezulton se shkak i përcaktuar si aksidentit është shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor nga enti pronar i rrugës, konkretisht neneve 14/1, 37/1, shkronja "a" dhe 38/7 të Kodit Rrugor. Sipas nenit 45 të Kodit Penal, enti pronar i rrugës, si institucion shtetëror, përjashtohet nga përgjegjësia penale dhe në rastin në gjykim, shkak i aksidentit ka qenë shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor nga ky institucion shtetëror dhe ky person nuk ka përgjegjësi penale;
- Në përfundim të hetimeve paraprake, është vlerësuar se çështja duhet të pushohet dhe është paraqitur kërkesa në gjykatë për pushimin e saj. Gjykata me vendimin e ankimuar, ka vendosur kthimin e akteve për plotësimin e hetimeve. Ky vendim i gjykatës është në kundërshtim me ligjin dhe nuk është i mbështetur në provat e administruara dhe për këtë arsye, duhet ndryshuar dhe çështja duhet të pushohet, pasi hetimet janë kryer të plota, si dhe bazuar në këtë prova nuk mund të ngrihet akuzë;
- Gjykata ka arsyetuar se ekspertimi auto-teknik është kontradiktor dhe nuk përcakton shkakun determinat për ardhjen e pasojës. Në ekspertim është përcaktuar qartë shkakur determinat i ardhjes së pasojës, duke përcaktuar si shkak faktin e shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor nga enti pronar i rrugës, e konkretisht 14/1, 37/1, shkronja "a" dhe 38/7 të Kodit Rrugor. Përcaktimi i shkakut determinat kërkon njohuri të posaçme dhe ky shkak nuk

mund të përcaktohet nga prokurori ose gjykata, por nga eksperti që ka njohuritë e posaçme. Nëse ekspertimi nuk është i qartë, gjykata mund të kishte thirrur ekspertin në seancëgjyqësore dhe do të krijonte një bindje më të drejtë, gjë që gjykata nuk e ka bërë;

- Gjukata ka lënë si detyra identifikimin e personave që kanë qenë të pranishëm në momentin e aksidentit (dëshmitarë okularë), si dhe verifikimi i gjendjes fizike e mendore të viktimit dhe më pas kryerjen e një ekspertimi të ri auto-teknik. Dy detyrat e para janë të pamundura për t'u kryer, pasi *së pari*, personi nën hetim nuk ka njohur asnjë person që ka qenë i pranishëm në momentin e aksidentit dhe *së dyti*, verifikimi i gjendjes fizike e mendore të viktimit, çfarë vlere provuese ka sepse askush nuk ka parë si ka qenë gjendja fizike e viktimit e mendore në momentin e aksidentit;

- Në përfundim, prokurori ka kërkuar ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe pranimin e kërkesës për pushimin e çështjes.

GJYKATA E APELIT KORÇË,

Mori në shqyrtim në dhomë këshillimi pa praninë e palëve dhe pasi dëgjoi relatorin e çështjes Dritan Hasani, si dhe pasi shqyrtoi në tërësi aktet e provat e fashikullit të gjykimit;

VËREN:

1. Prokurori ka paraqitur ankim kundër vendimit nr. 41-2021-1057 (223 SP), datë 24.3.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, duke kërkuar ndryshimin e këtij vendimi dhe pushimin e çështjes. Gjukata e shkallës së parë, me vendimin e ankimuar, ka vendosur kthimin e akteve prokurorit dhe vazhdimin e hetimeve në drejtim të identifikimit të personave që kanë të pranishëm në momentin e aksidentit dhe pyetjen e tyre, të marrjes së të dhënave nga familjarët e viktimit për gjendjen e tij fizike e mendore, si dhe të kryerjes së ekspertimit auto-teknik me grup ekspertësh. Kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë, ka paraqitur ankim prokurori, duke kërkuar ndryshimin e vendimit e pushimin e çështjes.

2. Ankimi u shqyrtua në dhomë këshillimi, bazuar në nenin 329/b, pika 6 dhe 329, pika 7, të Kodit të Procedurës Penale (KPP). Gjukata vëren se prokurori ka paraqitur ankim kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me vendimmarrjen për kthimin e çështjes për vazhdimin e hetimeve. Prokurori ka proceduar me paraqitjen e kërkesës për pushimin e çështjes, kërkesë që është gjykuar në seancë paraprake dhe ankuesi, ka paraqitur ankim vetëm kundër vendimit të gjykatës për kthimin e akteve e vazhdimin e hetimeve. Për këtë arsye, gjykata shqyrtoi ankimin në dhomë këshillimi, në përputhje me nenin 329/7 të KPP-së.

3. Nga aktet e fashikullit, rezulton se prokurori ka regjistruar procedimin penal për veprën e parashikuar nga neni 290/3 i Kodit Penal, mbi bazën e informacionit të policisë gjyqësore. Prokurori ka regjistruar procedimin penal nr. 1107, datë 11.11.2020 për faktin se në datë 10.11.2020, rreth orës 09:30, në qytetin e Maliqi, personi nën hetim Endri Isallari, ka qenë duke drejtuar automjetin e tij me targa AA927KO, kur ka goditur viktimit, të cilës i ka shkaktuar dëmtime në trup dhe më pas, ka vdekur. Në urdhrin për

regjistrimin e procedimit penal është regjistruar dhe emri i shtetasit Endri Isallari, të cilit i është atribuar vepra e parashikuar nga neni 290/3 i Kodit Penal. Në përfundim të hetimeve, prokurori duke vlerësuar se ekziston një shkak për të cilin ndjekja penale nuk duhet të vazhdojë, kjo pasi shkak i aksidentit është përcaktuar si shkelja e rregullave të qarkullimit nga enti pronar i rrugës, ent që përjashtohet nga përgjegjësia penale, ka paraqitur kërkesë për pushimin e çështjes ndaj personit nën hetim, bazuar në nenin 328/1, shkronja “d” të KPP-së.

4. Nga aktet dhe provat e marra gjatë hetimeve paraprahe, rezulton se personi nën hetim është i pajisur me leje drejtimit, të kategorisë “B”, e vlefshme deri në datë 6.7.2020. Ai është i punësuar pranë subjektit “Vita 2001” dhe kryen detyrën e shpërndarjes së qumështit, duke përdorur automjetin me targa AA927KO, që është në pronësi të një shtetasi tjetër. Në mëngjesin e datës 10.11.2020, ka marrë mjetin dhe rretj orës 09:20, ka shkuar në qytetin e Maliqit, për të kryer shpërndarjet në pikat e shitjes. Në një moment ka kaluar në një rrugicë, paralel me rrugën qendrore, e cila ndodhet pranë selisë së Partisë Demokratike Maliq, e pasi ka lënë mallin, në momentin që do të largohej, ka filluar të drejtojë mjetin, duke ecur mbrapsht dhe me pjesën e mbrapme të mjetit ka goditur viktimën. Ka ndaluar mjetin dhe aty kanë shkuar me shpejtësi disa persona e ka parë që viktimë ishte i moshuar e nuk mund të ngrihej. Në vendin e ngjarjes ka shkuar ambulanca dhe policia gjyqësore, ku viktimë është dërguar në spital dhe më pas, ka vdekur.

5. Policia gjyqësore ka shkuar në vendin e ngjarjes dhe ka mbajtur procesverbalin e këqyrjes së vendit të ngjarjes dhe të automjetit, por pa shoqëruar këqyrjen me tabelë fotografike. Shtetasit Endri Isallari i është bërë testi i aloklit dhe ka rezultuar se nuk kishte konsumuar pije alkoolike. Po kështu, është bërë këqyrja e kufomës së viktimës, e pa shoqëruar e tabelë fotografike, ku pasqyrohen dëmtimet trupore të shkaktuara nga aksidenti.

6. Është pyetur personi nën hetim, i cili ka deklaruar se pasi kishte lënë mallin, po drejtonte mjetin në një rrugicë paralel me rrugën qendrore dhe kur ka qenë duke ecur mbrapsht për shkak se rruga ka qenë shumë e ngushtë, ka dëgjuar një goditje në pjesën e pasme të mjetit. Ka ndaluar mjetin dhe pasi ka dalë, aty kanë shkuar disa persona, të cilët ia kënë thënë se pranë makinës ishte një person i shtrirë. Ka parë se personi që kishte goditur ishte i moshur dhe nuk mund të ngrihej. Më pas, ka njoftuar pronarin e mjetit për ngjarjen dhe ka qëndruar aty. Personi nën hetim ka deklaruar se para se të fillonte të ecte mbrapsht, ka parë pasqyrat dhe nuk ka konstatuar njeri dhe se para se të lëvizte nuk ka e ka parë shtetasin që ka goditur.

7. Është kryer ekspertimi mjeko-ligjor për konstatimin e dëmtimeve në shëndetin e viktimës dhe përcaktimin e shkakut të vdekjes së tij. Sipas ekspertimit mjeko-ligjor nr. 51, datë 10.11.2020, rezulton se në trupin e viktimës janë konstatuar politrauma, contuzion i rëndë i trurit, me thyerje të bazës së kafkës, thyerja e kockave të gjoksit në të dy anët, thyerje me plagë të hapura të këmbës së djathë në nivelin e kërcirit, këto dëmtime janë shkaktuar nga mjet të fortë mbretës, me mekanizmin e goditje-përplasje; si dhe se shkak i vdekjes është politrauma me contuzion të rëndë të trurit.

8. Është kryer ekspertimi auto-teknik në lidhje me përcaktimin e shkakut të aksidentit. Sipas ekspertimit, datë 3.12.2020, rezulton se shkak teknik i ndodhjes së këtij

aksidenti, shkelja fillestare, është kryer nga enti pronar i rrugës, i cili ka të bëjë me shkeljen e neneve 14 pika 1, 37, pika 1, shkronja “a” e 38, pika 7, të Kodit Rrugor. Në përgjigje tëdetyrave, eksperti ka arsyetuar: (i) automjeti me targa AA927KO ka qënë duke lëvizur brenda karaxhatës; drejtuesi i mjetit ka kryer manovër të pakujdesshme duke ecur injetro; shpejtësia e automjetit ka qënë e parregulluar në raport me normat e kategorisë së rrugës dhe me rrezikun që i ishte shfaqur mbrapa; në këto rrethana, drejtuesi i mjetit ka shkelur kërkesat e nenit 152, pika 1/a të Kodit Rrugor; (ii) nga ana e këmbësorit, viktimës, nuk konstatohen shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor, pasi ky shtetas nuk e ka parashikuar që automjeti lëvizte indjetro dhe përplasja ka ndodhur në kushtet e befasisë së plotë; (iii) nga enti pronar i rrugës konstatohen shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor, neni 14, pika 1, neni 37, pika 1, shkronja “a” dhe neni 38, pika 7 i Kodit Rrugor. Segmenti rrugor nuk ka qënë i shoqëruar me sinjalistikën e nevojshme vertikale, horizontale dhe të ndritshme, si dhe me elementët e sigurisë siç janë trotuaret. Nga ana e drejtuesit të mjetit nuk ka qënë e mundur shmangia e kontaktit ndërmjet mjetit e këmbësorit sepse drejtuesi nuk e ka konstatuar këmbësorin që po lëvizte pas mjetit. Në qoftë se viktimja do të kishte lëvizur në trotuare, të cilat në këtë pjesë të rrugës mungojnë, nuk do të ndodhte aksidenti.

9. Bazuar në faktin si më sipër, prokurori ka marrë vendim për përfundimin e hetimeve dhe ka hartuar kërkesën me objekt pushimin e çështjes që i përket procedimit penal nr. 1107, viti 2020, hetuar për veprën penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290/3 i Kodit Penal. Prokurori ka dorëzuar në gjykatë kërkesën për pushimin e çështjes, të cilës i ka bashkëlidhur aktet e veprimeve hetimore.

10. Prokurori ka kërkuar pushimin e çështjes për shkakun se ekziston rrethana për të cilën ndjekja penale nuk duhet të vazhdojë. Nepërmjet kërkesës dhe në seancë gjyqësore, ai deklaroi se shkelja është bërë nga enti pronar i rrugës, i cili nuk ka marrë masa për vendosjen e sinjalistikës dhe ndërtimin e trotuareve dhe pasoja ka ardhur për këtë shkak. Meqenëse enti pronar i rrugëve është person juridik publik institucion shtetëror, sipas nenit 45 të Kodit Penal nuk mban përgjegjësi penale. Shtetasi Endri Isallari dhe mbrojtësi i tij, kanë kërkuar pushimin e çështjes duke parashtruar se hetimet janë të plota.

11. Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se, në kushtet kur hetimet nuk janë kryer të plota, duhet të disponohet konform nenit 329, pika 3, shkronja “b” të KPP-së, duke i kthyer aktet prokurorit dhe duke urdhëruar të bëjë plotësimin e hetimeve. Në lidhje me përcaktimin e shkakut të akidentit, gjykata ka vlerësuar se ekspertimi auto-teknik është i paqartë dhe kontradiktor, si dhe ka konstatuar kryerjen e veprimeve hetimore jo të plota sa i përket moskryerjes së fotografimit gjatë këqyrjes së vendit të ngjarjes, mosverifikimin e pamjeve video që mund të jenë regjistruar pranë vendit të ngjarjes, eksperti nuk ka analizuar veprimet e mosveprimeve të drejtuesit të mjetit në raport me rregullat e qarkullimit rrugor, personi nën hetim ka pasur mundësi të konstatonte praninë e viktimës, bazuar në nenin 152 të Kodit Rrugor, si dhe nuk janë marrë të dhëna nga personat që kanë qënë të pranishëm në vendin e ngjarjes. Në përfundim, gjykata ka vlerësuar se hetimet duhet të vazhdojnë, duke përcaktuar dhe veprimet hetimore si vijon: marrjen e të dhënave nga personat që kanë qënë të pranishëm në momentin e aksidentit; marrjen e të dhënave nga familjarët e viktimës, në lidhje me gjendjen fizike e

mendore të tij; si dhe kryerjen e një ekspertimi tjetër auto-teknik me grup ekspertësh për të përcaktuar shkakun e aksidentit.

Vlerësimi i gjykatës së apelit.

12. Gjykata e apelit vëren se kundër vendimit të gjyqtarit të seancës paraprake, ka paraqitur ankim prokurori. Lidhur me të drejtën (legjitimimin) për të bërë ankim kundër vendimit për kthimin akteve prokurorit e vazhdimin e hetimeve, gjykata e apelit vëren se ligji ka përcaktuar subjektin që mund të bëjnë ankim kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë. E drejta e ankimit është përcaktuar në pikën 6, të nenit 329, të KPP-së, ku parashikohet se kundër vendimit për kthimin e akteve e vazhdimin e hetimeve, mund të bëjë ankim prokurori. Në rastin në shqyrtim, gjykata e shkallës së parë ka vendosur sipas nenit 329/3, shkronja "b", të KPP-së dhe të drejtën për të bërë ankim kundër këtij vendimi e ka vetëm prokurori, bazuar në pikën 6, të kësaj dispozite. I pandehuri dhe viktima mund të bëjnë ankim kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë, në rastin kur kjo e fundit vendos pushimin e akuzës ose çështjes. Gjykata e apelit vëren se kundër vendimit të gjyqtarit të seancës paraprake për kthimin e akteve e vazhdimin e hetimeve mund të bëjë ankim vetëm prokurori.

13. Prokurori është subjekt që legjitimohet për të bërë ankim kundër vendimit për kthimin e akteve e vazhdimin e hetimeve, pasi është subjekt i parashikuar shprehimisht në ligj për ushtrimin e kësaj të drejte. Prokurori ka paraqitur shkaqe në ankim, lidhur me nevojën për marrjen e provave të caktuara nga gjykata. Gjykata e apelit vlerëson të shqyrtojë shkaqet e ankimi lidhur me nevojën për vazhdimin e hetimeve sipas drejtimeve të përcaktuara nga gjykata e shkallës së parë.

14. Gjykata e apelit vëren se konstatimet e gjykatës së shkallës së parë, në lidhje me moskryerjen e hetimeve të plota për përcaktimin e rrethanave të aksidentit dhe shkakut të tij. Gjykata vëren se hetimet janë të pa plota që veprimet e para hetimore, pasi këqyrja e vendit të ngjarjes nuk është shoqëruar me fotografim dhe procesverbalit të këqyrjes nuk i është bashkëlidhur tabela fotografike. Gjithashtu, nuk është kryer veprimi hetimor i verifikimit nëse në vendin e ngjarjes ka pasur kamera nga subjekte të ndryshme, që mund të kishin regjistruar në video aksidentin e ndodhur. Me të drejtë, gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se këto veprime janë të papërsëritshme e nuk mund të kryhen pas kalimit të një kohe të caktuar nga ndodhja e aksidentit. Për këto arsye, gjykata e apelit çmon se këto veprime për shkak të natyrës së tyre të papërsëritshme nuk mund të kryehen me kthimin e akteve prokurorit e vazhdimin e hetimeve.

15. Në lidhje me kryerjen e veprimeve të tjera hetimore, gjykata e apelit i çmon të bazuar dhe i shërbejnë hetimit të plotë të rrethanave të aksidentit dhe përcaktimit të shkakut të tij. Marrja e të dhënave nga personat që kanë qenë të pranishëm në momentin e aksidentit është i nevojshëm për sqarimin e rrethanave të aksidentit; pozicionimin e mjetit e të viktimës, faktit nëse drejtuesi i mjetit mund të konstatonte viktimën dhe rrethanat e goditjes së viktimës e dëmtimin e tij. Organi procedues duhet të kërkojë informacion jo vetëm nga personi nën hetim, për personat që kanë qenë të pranishëm në momentin e aksidentit, por edhe nga burimet e tjera të informacionit që disponon policia gjyqësore. Nëse organi procedues identifikon persona të caktuar, që kanë qenë të pranishëm në momentin e aksidentit, duhet të marrë të dhëna në lidhje me rrethanat e

aksidentit dhe nëse kjo nuk është e mundur, të aryetojë mosidentifikimin e personave që kanë qenë të pranishëm. Sa i përket marrjes së të dhënave nga familjarët e viktimës, për gjendjen e tij fizike e mendore, ky veprim shërben për hetimin e sjelljes së viktimës në raport me rregullat e qarkullimit rrugor dhe mundësinë e shmangies së aksidentit. Gjykata e apelit çmon se kryerja e këtyre veprimeve hetimore është e nevojshme për hetimin e plotë të rrethanave të aksidentit dhe përcaktimin e shkakut të tij.

16. Sa i përket nevojës së kryerjes të një ekspertimi tjetër auto-teknik, gjykata e apelit çmon se është i nevojshëm për hetimin e plotë të shkakut të aksidentit. Kjo *së pari*, duke marrë parasysh pasojën e rëndë që ka ndodhur, pasi nga aksidenti është shkaktuar vdekja e shtetasit dhe përcaktimi i shkakut të kësaj pasojë, kërkon hetim sa më të plotë për përcaktimin e shkakut, duke marrë mendim nga grup ekspertësh. *Së dyti*, vlerësimi me grup ekspertësh është i nevojshëm duke marrë në konsideratë faktin se edhe për personin nën hetim janë konstatuar shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor dhe vlerësimi i kësaj shkeljeje në raport me shkeljet e kryera nga enti pronar i rrugës, është i nevojshëm të kryhet nga grup ekspertësh, për të pasur një ekspertim sa më të plotë. Për rrjedhojë, gjykata e apelit çmon se kryerja e ekspertimit auto-teknik me grup ekspertësh është i nevojshëm për hetimin e plotë të shkakut të aksidentit dhe përcaktimit të përgjegjësisë penale.

17. Mbështetur në arsyetimin e mësipërm, gjykata e apelit çmon se vendimi i gjykatës së shkallës së parë është i bazuar në ligj e duhet të lihet në fuqi. Shkaqet e ngritura në ankim nga prokurori, nuk tregojnë se hetimet janë të plota e nuk ka hetime të tjera që mund të kryhen në funksion të hetimit të plotë të rrethanave të aksidentit dhe përcaktimit të shkakut të tij, e në përfundim të përgjegjësisë penale. Për këto arsye, gjykata e apelit vlerëson të vendosë lënien në fuqi të vendimit të shkallës së parë.

Përfundimisht, gjykata e apelit, mbështetur në arsyetimin e mësipër, çmon se ankimi i prokurori nuk përmban shkaqe që cenojnë vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe për rrjedhojë, vendos lënien në fuqi të këtij vendimi.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata e Apelit Korçë bazuar në nenin 329/3 dhe 428/1, shkronja "a", të Kodit të Procedurës Penale;

VENDOSI:

- Lënien në fuqi të vendimit nr. 41-2021-1057 (223 SP), datë 24.3.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.
- Kundër këtij vendimi mund të bëhet rekurs në Gjykatën e Lartë, sipas ligjit.

U shpall në Korçë, sot më 28 maj 2021.

ANËTARE

Arta DUKA

ANËTARE

Elbana LLURI

KRYESUES

Dritan HASANI